



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

### KRYETARE

Nr. 483/1 Prot.

Shkodër, më 04/01/ 2024

### V E N D I M

Nr.20, Datë 28 /12/ 2023

**“Për miratimin e Strukturës Organizative dhe nivelin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024”**

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e Datës 28.12.2023, me propozim të Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër “Për miratimin e Strukturës Organizative dhe nivelin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër”, bazuar në: Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përkatësisht në Nenin 8, pika 2) dhe Nenin 77, gërma ç); Ligjin Nr. 152/2013 ‘Për Nëpunësin Civil’ (i ndryshuar); Ligjin Nr.7961, Datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë ” (i ndryshuar); VKM-në Nr.328 Datë 31.05.2023 ”Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 35/2023”Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vëndi”, Vendimin Nr. 142, Datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” Ligjin Nr. 97, Datë 07.12.2023, ”Për buxhetin e Vitit 2024”;; ”, Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e



Këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **15 Vota Pro, 0 Vota Kunder** dhe **0 Vota**

**Abstenim,**

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Strukturën Organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për Vitin 2024 me gjithsejt 13 (trembëdhjetë ) persona, 3 (tre) të zgjedhur dhe 10 (dhjetë ) personel administrativ.
2. Burimet financiare do jenë transferta e pakushtëzuar, sipas detajimit të Buxhetit të Vitit 2024.
3. Struktura e niveli i pagave për Administratën e Këshillit të Qarkut Shkodër për Vitin 2024, do të jetë sipas tabelës bashkangjitur.
4. Efektet financiare do të fillojnë nga Data 01.01.2024.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

**KRYETARE**

**Marina DUHANI**







**KESHILLI I QARKUT SHKODER**  
**STRUKTURA DHE NIVELI I PAGAVE TË ADMINISTRATËS SË**  
**KESHILLIT TE QARKUT PER VITIN 2024**

Ren	Nr Pu nonjës sipas drejt.	Njesia Strukturore	Klasa	Klasa Kategoria	Paga e nivelit kualifikimi	Shtesa 2% e vjeter. mbi pag e grupit	Paga per pozicion dhe per klasë
1	2	3		4	5	6	7
1	1	Kryetar I Këshillit të Qarkut					170,000
2	1	Zv.Kryetari Këshillit të Qarkut					125,000
3	1	Sekretar i Këshillit te Qarkut		I-b	14,000	2%	112,500
		<b>Drejtoria e Financës dhe Buxhetit</b>					
1	1	<b>Drejtor Drejtorie</b>		II-b	14,000	2%	91,000
2	1	Përgjegjes Sektori I Prokurimeve		III-a1	14,000	2%	80,300
3	1	Specialist I Sherbimeve & Sekretari Arkives		III-b	14,000	2%	70,000
4	1	Specialist I Programim Zhvillimit & Burimeve Njerezore		III-b	14,000	2%	70,000
5	1	Punonjës I funksioneve mbeshetese, operative, magazine	VIII			1%	47,000
		<b>Drejtoria e Zhvillimit &amp; Bashkep. me jashte</b>					
6	1	<b>Drejtor Drejtorie</b>		II-b	14,000	2%	91,000
7	1	Përgjegjes Sektori per financen dhe zbatim projektesh		III-a1	14,000	2%	80,300
8	1	Specialist I Planifikimit dhe Zhvillimit Territorial		III-b	14,000	2%	70,000
9	1	Specialist Arsimin, Kulturen dhe Çështjeve Sociale		III-b	14,000	2%	70,000
10	1	Specialist I marredhenjeve publike dhe promovimit		III-b	14,000	2%	70,000

Shtesa per vjetersi ne punë e përcakuar në masën 2%, jepet pas çdo viti pune, deri ne 25 vjet dhe llogaritet mbi rrujetin e kualifikimit.  
 Shtesa per vjetersi ne punë e përcakuar në masën 1%, jepet pas çdo viti pune, deri ne 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën per klasë.

